



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 191 prot.

Kamëz, më 21.12.2022

V E N D I M
Nr. 169 .Datë 21/12 2022
M B I

**“MIRATIMIN E FONDIT 3% I SIGURUAR NGA NDËRTIMI I SUBJEKTEVE
PRIVATE TË PËRDORËT PËR PROGRAMET E STREHIMIT SOCIAL”**

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 21.12.2022, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.145 Datë 19.12.2022 në mbështetje të Kushtetutës, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenin 19 pika 1 dhe 2 i Ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social, Vendimit nr. 384, datë 12.6.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutuar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, VKM nr.362 datë 20.05.2019 “Për kriteret e dhënies subvencionimit qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”; VKM nr. 459 datë 03.09.2019 “Rregullat për administrimin e kërkesave të njëjësive qeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionimit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet NJQV dhe ministrisë përgjegjëse për strehim” VKB nr.54 datë 20.12.2019 “Për kalimin e fondit 3 % në favor të Bashkisë Kamëz” **Këshilli Bashkiak Kamëz**”;

V E N D O S I:

1. Miratimin e fondit të krijuar nga subjektet private që aplikojnë për leje zhvillimi dhe ndërtimi, për ndërtime me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2000 metra katrorë, sipas pikës 1 dhe 2 të nenit 19 të ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social” dhe VKB nr.54 datë 20.12.2019 “Për kalimin e fondit 3 % në favor të Bashkisë Kamëz” të përdoret për programet e strehimit social.
2. Të ngarkojë Drejtorinë e Emergjencave Civile dhe Strehimit, Sektorin e Strehimit Social Drejtorinë e Financës dhe Kontabilitetit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

KRYETAR KËSHILLI

Hysen KOLDASHI